



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obština-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “INFINITT shpk” të datës 15.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “96 Mirëmbajtja e institucioneve vartëse dhe hapësirave për art dhe kulturë LOT 3” me nr. të prokurimit 616-26-2525-2-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “INFINITT shpk” të datës 15.06.2026 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “96 Mirëmbajtja e institucioneve vartëse dhe hapësirave për art dhe kulturë LOT 3” me nr. të prokurimit 616-26-2525-2-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “INFINITT shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 15.06.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “96 Mirëmbajtja e institucioneve vartëse dhe hapësirave për art dhe kulturë LOT 3” me nr. të prokurimit 616-26-2525-2-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ për prokurim publik. AK/zyra e prokurimit me 09.06.2026. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate ne LOT 3 OE MEGRANT ING SH.P.K. Per kete LOT oferta e kompanise sone ka qene me e ulet se cmimi i OE te rekomanduar per kontrate. Pasiqe AK na eshte drejtuar me leter standarde per tenderuesin e pasuksesshem e jo tenderuesin e eliminuar, citoj: Oferta juaj eshte vleresuar si oferte e pergjegjshme ne perputhje me kerkesat e njoftimit per kontrate dhe dosjen e tenderit, por eshte e pasuksesshme per shkak se keni ofruar cmim me te larte, me cmim prej 1575.00euro. Ne me 10.06. i jemi drejtuar me email zyres se prokurimit per kete qeshtje mirepo nuk kemi pranuar pergjigje perse nuk jemi rekomanduar per kontrate dhe ne LOT3. Ky konstatim i AK/komisionit vleresues nuk qendron, oferta e kompanise sone eshte 1575.00euro ndersa oferta e OE te rekomanduar per kontrate ne LOT 3 eshte 1760.00euro. AK ne nenin 2.5 te FDT-se ka cekur se numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është: 2 prandaj kerkojme nga zyra e prokurimit qe te ktheje lenden ne ri-vleresim per LOT 3 dhe te rekomandohet per kontrate kompania jone konform nenit 60 te LPP-se si oferta e pergjegjshme me cmimin me te ulet. Mare parasysh faktet e lartecakura konstatojme se AK/komisioni vleresues jashteligjshem ka rekomanduar per kontrate OE Migrant Ing shpk per LOT3 megjithese oferta e kompanise sone ka qene me cmim me te ulet".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues në letrën standarde të parashtruesit janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.06.2026



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.